Pa. nr. 08-153

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëritë: Daimler Truck me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, dhe Aktiebolaget Volvo me seli kryesore në Gropegardsgatan 2, 405 08 Göteborg, Suedi, dorëzuar nëpërmjet avokates Lupka Noveska Andonova nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 17.12.2024, miratoi

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Daimler Truck me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, dhe Aktiebolaget Volvo me seli kryesore në Gropegårdsgatan 2, 405 08 Göteborg, Suedi, do të formojnë një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota që do të fokusohet në kërkimin, zhvillimin dhe komercializimin e një platforme të definuar me softuer për automjete komerciale, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë tarifë administrative për njoftim për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 denarë dhe për vendimin në vlerë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), më datë 19.11.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni), u dorëzua njoftimi për përqendrim nga Daimler Truck me seli të regjistruar në Fasanenweg 10, 70771 Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, dhe Aktiebolaget Volvo me seli kryesore në Gropegårdsgatan 2, 405 08 Göteborg, Suedi, me të cilin Daimler Truck dhe Aktiebolaget Volvo do të formojnë një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota që do të fokusohet në kërkimin, zhvillimin dhe komercializimin e një platforme të definuar me softuer për automjete komerciale.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe anekset e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

- **Daimler Truck** me seli në Leinfelden-Echterdingen, Gjermani, është një shoqëri 100% e varur e Daimler Truck Holding AG, një shoqëri e listuar në bursën e Frankfurtit. Daimler Truck është shoqëria operative udhëheqëse për aktivitetet e Daimler Truck Group lidhur me kamionë dhe autobusë me markat si Mercedes-Benz Trucks, Freightliner, Mitsubishi Fuso, Western Star, Setra dhe Rizon.

Daimler Truck nuk ka një shoqëri të varur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, por realizon të ardhura në tregun maqedonas përmes shitjes së automjeteve nëpërmjet distributorëve të pavarur.

- **Aktiebolaget Volvo** është një shoqëri ndërkombëtare me seli në Goteborg, Suedi, e cila është e listuar publikisht në bursën Nasdaq OMX Nordic. Nëpërmjet aksioneve të saj në shoqëritë e Grupit Volvo ("**Grupi Volvo**"), Volvo është aktive në nivel global në prodhimin dhe shitjen e kamionëve për trafik dhe jashtë trafikut, autobusëve, pajisjeve ndërtimore dhe transportit detar, për trafik dhe jashtë trafikut dhe motorëve industrialë. Portofoli i markave të Grupit Volvo përbëhet nga Volvo, Volvo Penta, Rokbak, Renault Trucks, Prevost, Nova Bus dhe Mack.

Njësitë kryesore afariste të Volvos janë:

- Kamionë**:** zhvillimi, prodhimi dhe marketingu i kamionëve të mesëm deri të rëndë për transport rajonal dhe operacione ndërtimi në distanca të gjata. Në ZEE (Zona Ekonomike Evropiane), këta kamionë shiten nën markat Volvo Trucks dhe Renault Trucks.

- Autobusë**:** zhvillimi, prodhimi dhe marketingu i autobusëve urbanë dhe ndër urbane, autobusëve të transportit për distanca të gjata (coaches) dhe shasive. Në ZEE, këta autobusë shiten nën markën Volvo.

- Motorë**:** zhvillimi, prodhimi dhe marketingu i sistemeve të fuqizimit për qëllime detare dhe industriale nën markën Volvo Penta. Volvo është aktive edhe në prodhimin e motorëve për automjetet në autostradë.

- Pajisje ndërtimore**:** zhvillimi, prodhimi dhe marketingu i pajisjeve ndërtimore dhe industrive të ngjashme, duke përfshirë ekskavatorët me rrota dhe me zinxhirë, automjetet e ngarkesave të artikuluar, automjetet e rënda të ngarkesave me rrota, pajisjet e demolimit, menaxhuesit e mbeturinave, ngjeshësit dhe një sërë pajisjesh kompakte (si ngarkuesit mini dhe ekskavatorët mini). Në ZEE, këto aktivitete kryhen nën markat Volvo (pajisje ndërtimore) dhe Rokbak.

- Menaxhimi financiar**:** shërbime të financimit të klientëve.

Grupi Volvo ka një shoqëri të varur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut – **VOLVO MAKEDONIJA VTC SHPKNJP**, me seli të regjistruar në rr. 112 nr. 2/14 Qojlija, Petrovec, Shkup 1043 dhe veprimtari prioritare – tregtia me automjete të tjera motorike.

- **Ndërmarrja e përbashkët** do të themelohet në formën juridike të një shoqërie aksionare sipas ligjeve të Suedisë (në suedisht: *Aktiebolag*). Mund të ketë një shoqëri të varur në pronësi të plotë dhe në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Gjermanisë (në gjermanisht: *Gesellschaft mit beschränkten Haftung*) dhe potencialisht shoqëri shtesë të varura, duke përfshirë një në Indi e cila do të fokusohet kryesisht në

nevojat për kërkim dhe zhvillim. Ndërmarrja e përbashkët fillimisht do të themelohet si shoqëri e varur në pronësi të plotë të Grupit Volvo. Në datën e mbylljes së Transaksionit, Daimler Truck do të fitojë 50% të aksioneve në Ndërmarrjen e përbashkët.

Ndërmarrja e përbashkët do të jetë nën kontrollin e përbashkët, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga parashtruesit, ajo do të jetë një person juridik i veçantë me identitetin e vet korporativ dhe do të ketë mjete të mjaftueshme financiare për të funksionuar në mënyrë të pavarur në baza të përhershme.

Ndërmarrja e përbashkët do të fokusohet në kërkimin, zhvillimin dhe komercializimin e Platformës SDV për automjete komerciale. SDV (Automjeti i Definuar me Softuer) paraqet një trend në zhvillimin e automjeteve, ku përvoja e klientit në automjet gjithnjë e më shumë varet nga softueri, dhe jo, si në të kaluarën kryesisht nga hardueri i automjetit. Automjetet e definuara me softuer mundësojnë forma të reja të lidhjes, automatizimit dhe karakteristikave të personalizuara.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pika 6 b) e Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ para Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Ана Николоска